



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:228184

Datë: 24.11.2022

Numri i dokumentit: 03686750

Pml.nr.461/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Valdete Daka dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, në çështjen penale ndaj të pandehurave A. (N.) P., nga fshati N., komuna e P., A. (N.) R., nga fshati L., komuna e P., si dhe R. (A.) K., nga fshati L., komuna e P., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje sulmi nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurës A.R., avokatit Blerim Ademaj, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm DP.PP.nr.336/2022 të datës 03.11.2022 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PN1DP.nr.1561/2022 të datës 11.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 24.11.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me pranimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurës A.R., e sipas detyrës zyrtare edhe për të pandehurat A.P. e R.K., ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm DP.PP.nr.336/2022 të datës 03.11.2022 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PN1DP.nr.1561/2022 të datës 11.11.2022, ashtu që të pandehurave iu ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njëjtat lëshohen menjëherë për tu mbrojtur në liri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin DP.PP.nr.336/2022 e datës 03.11.2022, të pandehurave A.P., A.R. dhe R.K., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje sulmi nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me 31 të KPRK, iu ka Caktuar masën e paraburgimit për 1 (një) muaj e cila sipas këtij aktvendimi do t'iu zgjasë deri më datën 01.12.2022, konform nenit 187 par.1 dhe 2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PN1DP.nr.1561/2022 të datës 11.11.2022, e ka refuzuar ankesën e mbrojtëses se të pandehurës si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurës A.R., avokatit Blerim Ademaj nga Peja, për shkak të shkeljes esenciale të ligjit të dispozitave të procedurës penale të KPPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën, aktvendimet e atakuara të ndryshohen dhe të pandehurës Altina Rexhepi, t'ia ndërpritet masa e paraburgimit për tu mbrojtur në liri.

Prokurori i Shtetit Kosovës, me parashtrësën KMLP.III.nr.162/2021 e datës 23.11.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale dhe pas vlerësimit të pretendimeve gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara, ngase pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurës, kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimet e kundërshtuara duhen ndryshuar dhe e pandehura duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se këto aktvendime janë të paqëndrueshme, për çka me të drejtë tërheq vërejtjen mbrojtësi në kërkesën e tij.

Kjo gjykatë konsideron se nuk qëndron baza ligjore e parashikuar me dispozitat e nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPPK, sepse siç rezulton nga shkresat e lëndës nuk ka arsye për të besuar se të pandehurat do të asgjësojnë, fshehin apo ndryshojnë provat e veprës penale, nuk qëndron fakti se të pandehura do të mund të ndikojnë tek e dëmtuara apo dëshmitarët, sepse provat gjegjësisht deklaratat e tyre ekzistojnë në shkresat e lëndës.

Po ashtu, edhe sa i përket bazës ligjore të parashikuar me dispozitën e nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPPK, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me rastin e caktimit të masës së paraburgimit nuk kanë dhënë ndonjë arsye konkrete përpos përshkrimit të veprimeve të të pandehurave. Kështu, nga shkresat e lëndës del se të pandehurat

nuk kanë rënë në kundërshtim me ligjin më parë, nuk janë të evidentuar për ndonjë procedim penal aktual dhe nga shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë indikacion se me gjetjen e tyre në liri ato do të mund ta përsërisin veprën penale.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë dhënë arsyetim bindës dhe të qëndrueshëm përkitazi me bazat e paraburgimit. Përkatësisht nuk kanë analizuar në mënyrë faktet vendimtare apo bazat e artikulueshme për caktimin e paraburgimit, për më tepër kanë bërë përshkrim formal të shkaqeve dhe kriterëve të parashikuara me ligj, dhe kanë paraqitur të dhëna të pa konfirmuara dhe të cilat bien ndesh me shkresat e lëndës penale pasi që është evidente se dëshmitarja G.N. është dëgjuar në cilësinë e dëshmitares, kurse ndikimi në të dëmtuarën është i karakterit abstrakt dhe pa asnjë mbështetje në shkresat e lëndës. Gjithashtu duke vlerësuar arsyetimin e gjykatave respektive përkitazi me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 pika 1.2.3 të KPPK-së, është evidente se arsyetimet janë të natyrës supozuese dhe pa mbështetje në prova konkrete, meqë rreziku i përsëritjes duhet të jetë i konkretizuar dhe i bazuar në prova konkrete dhe në asnjë rrethanë në të dhëna të pakonfirmuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes posaçërisht ka pasur parasysh dhe ka aplikuar nenin 187 të KPPK-së se: *“Paraburgimi caktohet vetëm kur përmbushen kushtet e paraparë me ligj (përveç dyshimit të bazuar edhe bazat e artikulueshme nga pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të par.1.2 të nenit të lartcekur), dhe në rast se nuk përmbushen këto kushte (165 par.4 i KPP) i pandehuri apo e pandehura lirohet”,* që nga interpretimi logjik i kësaj dispozite mund të konkludohet se paraburgimi paraqet masën e fundit *“ultima ratio”* dhe e cila duhet të aplikohet vetëm përjashtimisht dhe nën kushte të përcaktuara dhe të argumentuara.

Edhe përkundër faktit se të pandehurat A.P. e R.K. nuk kanë ushtrua kërkesa, kjo gjykatë vlerësoi se arsyet për të cilat ka marr vendim në dobi të pandehurës Altina Rexhepi, që nuk janë të natyrës personale shkojnë në dobi edhe të të pandehurave tjera, të cilat nuk kanë parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjykata konform nenit 397 të KPRK-së, (beneficium cohaesionis) vendosi edhe për këto të pandehura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për këtë arsye, kolegji i kësaj gjykate, konform nenit 438 par.1 pika 1.1 të KPPK, aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.461/2022 me datë 24.12.2022

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi